



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.13, datë 25. 02. 2021

**“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR DHËNIEN E TITUJVE  
VENDORE TË NDERIT NË BASHKINË SKRAPAR”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 25.02.2021, në zbatim të Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë", nenit 14, nenit 15, pika 1, gërma a), pika 2, neni 17, pika 1, VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 " Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie dhe medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë", Kreu I, pika 2, ku përcaktohet se: “Komisioni ngrihet me urdhër të autoritetit përgjegjës çdo fillim viti kalendarik”

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e Komisionit Këshillimor për Dhënie dhe Titujve Vendore të Nderit në Bashkinë Skrapar.
2. Komisioni Këshillimor për Dhënie dhe Titujve Vendore të Nderit në Bashkinë Skrapar, do të përbëhet nga 5 (pesë ) anëtarë si më poshtë:

Znj. Fatmira Hasko  
Z. Shkëlqim Zaimi  
Znj. Edlira Shkëmbi  
Z. Besnik Demko  
Znj. Hava Nuellari

3. Komisioni Këshillimor për Dhënie dhe Titujve Vendore të Nderit në Bashkinë Skrapar i ngritur në zbatim të këtij vendimi do të ushtrojë kompetencat e tij për vitin 2021.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Vendimi u miratua me 15 vota pro, vota kundër - s’ka, vota abstenim - s’ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

**KRYETARE KESHILLIT BASHKIAK**

**Edlira SHKËMBI**

